

AKTAKUZAT E NGRITURA PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVËS JANAR – QERSHOR 2025

BULETIN | SHTATOR 2025

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë, monitoron proceset gjyqësore për krimet e luftës pranë gjykatave të Kosovës. FDHK, në vazhdimësi, ka publikuar dhe do të publikojë analiza të rasteve dhe buletine, që do t'i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi këto procese gjyqësore.

Ky buletin paraqet të dhënat e përgjithshme mbi të gjitha aktakuzat e ngritura për krimet e luftës nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) për periudhën janar – qershor të vitit 2025, duke përfshirë këtu edhe aktakuzat e ngritura në mungesë të të akuzuarit.

Gjatë kësaj periudhe kohore, nga **Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) janë ngritur gjashtë (6) aktakuza**; ndaj dy (2) prej tyre do të zhvillohet procedurë e rregullt, dhe atë në rastet: *Prokurori kundër Jusuf Shujakut* dhe *Prokurori kundër Dragan Ristiqit*. Ndërkaq, katër (4) janë ngritur në mungesë të të akuzuarit, dhe atë në lëndët: *Prokurori kundër C.K.*, *Prokurori kundër M.I.*, *Prokurori kundër R.V.*, *A.Ç.* dhe *M.V.*, dhe *Prokurori kundër J.J.* dhe *V.T.*

Më poshtë është paraqitur shkurtimisht përmbajtja e aktakuzave dhe veprave penale me të cilat ngarkohen të akuzuarit. Disa nga të akuzuarit janë identifikuar vetëm me inicialet e tyre, pasi aktakuzat e tyre nuk janë bërë të njohura për publikun deri në momentin e publikimit të këtij buletini.

1. PROKURORI KUNDËR JUSUF SHUJAKUT

Policia e Kosovës, më datë 27 prill 2024, ka arrestuar të pandehurin Jusuf Shujak, nën dyshimet se i njëjti ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), pas hapjes së hetimeve më datë 27 prill 2024, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit Jusuf Shujak më datë 24 janar 2025, nën dyshimin se i njëjti ka kryer *krime lufte kundër popullsisë civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Shujak, gjatë muajit maj të vitit 1999, gjatë kohës së luftës në Kosovë, në fshatrat e Komunës së Gjakovës/Đakovica, si pjesëtar i forcave serbe, i uniformuar dhe i armatosur, ka marrë pjesë në vrasjen e tre (3) civilëve të nacionalitetit shqiptarë, dëbim dhe shkatërrim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të popullsisë civile shqiptare, të cilët nuk ishin të përfshirë në luftë.

Më 13 shkurt të vitit 2025, është mbajtur shqyrtimi fillestar pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština.

Deri në momentin e publikimit të këtij buletini, shqyrtimi kryesor në këtë rast nuk ka filluar.

2. PROKURORI KUNDËR C.K. (NË MUNGESË)

PSRK, më datë 27 janar të vitit 2025, ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër C.K., nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*, aktualisht sipas KPRK- së e inkriminuar si *krim kundër njerëzimit*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, si pjesëtar i mobilizuar i forcave policore të MPB-së së Serbisë, gjatë muajit prill të vitit 1999, gjatë kohës së luftës në Kosovë, në rrethinën e Komunës së Vushtrrisë/Vučitrn, në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur, ka kryer dhunim seksual ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptar.

Deri në momentin e publikimit të këtij buletini, shqyrtimi kryesor në këtë rast nuk ka filluar.

3. PROKURORI KUNDËR M.I. (NË MUNGESË)

PSRK, më datë 13 mars të vitit 2025, ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër M.I., nën dyshimin se ka kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, gjatë vitit 1998, në rrethinën e Komunës së Gjakovës/Đakovica, gjatë kohës së luftës në Kosovë, i uniformuar në uniformë policore dhe i armatosur, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave policore, ka marrë pjesë drejtpërdrejt në vrasjen e një (1) personi dhe në keqtrajtimin e qytetarëve civilë të nacionalitetit shqiptar. Po ashtu, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, në bashkëkryerje me persona të tjerë të armatosur, ka kryer dhunim seksual ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptar.

Deri në momentin e publikimit të këtij buletini, shqyrtimi kryesor në këtë rast nuk ka filluar.

4. PROKURORI KUNDËR R.V., A.Ç. DHE M.V (NË MUNGESË)

PSRK, më datë 21 mars të vitit 2025, ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër R.V., A.Ç. dhe M.V., nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, në të cilat bënin pjesë edhe të pandehurit, më datë 7 maj të vitit 1999, gjatë kohës së luftës në Kosovë, në fshatin Ozdrim/Ozrim dhe fshatrat përreth të Komunës së Pejës/Peć, të armatosur dhe të uniformuar, kanë kryer vrasjen e rreth katërbëdhjetë (14) civilëve, bastisje, tortura dhe trajtim në mënyrë mizore dhe çnjerëzore, mbajtje në kushte skllavërie, dëbim dhe dëbërim të dhjetëra civilëve shqiptarë, si dhe plaçkitje, djegie dhe shkatërrim të shtëpive të popullsisë civile të nacionalitetit shqiptar, të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftë.

Deri në momentin e publikimit të këtij buletini, shqyrtimi kryesor në këtë rast nuk ka filluar.

5. PROKURORI KUNDËR DRAGAN RISTIQT

Policia e Kosovës, më datë 25 shkurt 2025, ka arrestuar të pandehurin Dragan Ristiç, nën dyshimin se i njëjti ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), pas hapjes së hetimeve më datë 26 shkurt 2025, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit Dragan Ristiç më datë 27 qershor 2025, nën dyshimin se i njëjti ka kryer *krime lufte kundër popullsisë civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Ristiç, gjatë muajit maj të vitit 1999, gjatë kohës së luftës në Kosovë, në territorin e qytetit të Gjakovës/Đakovica, në bashkëkryerje me forcat policore dhe ushtarake, ku bënte pjesë edhe i pandehuri, ka marrë pjesë në vrasje, keqtrajtime dhe arrestime, dëbime dhe shkatërrime të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të popullsisë civile të nacionalitetit shqiptar, të cilët nuk ishin të përfshirë në luftë.

Shqyrtimi fillestar është planifikuar të mbahet më datë 22 korrik të vitit 2025 pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština.

6. PROKURORI KUNDËR J.J. DHE V.T. (NË MUNGESË)

PSRK, më datë 27 qershor të vitit 2025, ka ngritur aktakuzë në mungesë kundër J.J. dhe V.T., nën dyshimin se kanë kryer veprën penale *krim i luftës kundër popullsisë civile*.

Sipas PSRK, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit, më datë 30 mars të vitit 1999, gjatë kohës së luftës në Kosovë, në fshatin Kaçanik i Vjetër/Stari Kačanik, Komuna e Kačanikut/Kaçanik, të uniformuar me uniforma të policisë serbe dhe të armatosur, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të policisë, ushtrisë dhe forcave paramilitare serbe, kanë marrë pjesë në vrasje, maltretime fizike dhe psikike, plaçkitje të pasurisë së luajtshme të popullsisë civile të nacionalitetit shqiptar, të cilët nuk ishin të përfshirë në luftë.

Deri në momentin e publikimit të këtij buletini, shqyrtimi kryesor në këtë rast nuk ka filluar.

GJETJET E FDHK:

Pas vitit 2023 në Kosovë po vërehet një trend i dominimit të ngritjes së aktakuzave në mungesë, sidomos në rastet që lidhen me krimet e luftës. Kjo praktikë rrezikon të shndërrohet në mënyrë të zakonshme të trajtimit të këtyre rasteve, gjë që mund të ndikojë negativisht në efikasitetin dhe besueshmërinë e procesit gjyqësor.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga organizata National Endowment for Democracy përmes projektit të quajtur "Përkrahja e drejtësisë tranzicionale, dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e organizatës National Endowment for Democracy (NED).



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD